

SHQIPTARËT, NJË RACË E VJETËR²⁴⁹

Vendi malor në brigjet e Adriatikut, për më shumë se 2500 vjet ka qenë shtëpia e dy fiseve: Gegë dhe Toskë. Këto dy fise, përballë të gjitha shtypjeve të kohës kanë ruajtur identitetin racor në një masë të pashembullt në Ballkanin e trazuar.

Përgjatë gjysmës perëndimore të gadishullit të Ballkanit, në Bosnjë, Serbi, Mal të Zi dhe Shqipëri, janë gjetur mbetje të një race shumë të lashtë në shpella prehistorike. Kjo bashkësi primitive punonte bronzin me mjeshtëri, dhe ishin ndër të parët në Europë që filluan të përdorin hekurin. Origjina e tyre ka humbur bashkë me të shkuarën. Rreth vitit 600 p.e.s., ata u pushtuan dhe ka mundësi të jenë ndikuar nga Keltët e Veriut. Shqiptarët e kanë prejardhjen e tyre nga kjo përzierje kelto-ilire.

Në këtë mënyrë, shqiptari është banori më i lashtë i gadishullit të Ballkanit. Fakti që u ka mbijetuar pushtimeve dhe sundimit romak, bullgar, serb dhe turk, duke mbetur plotësisht shqiptar, në mënyrë të mjaftueshme provon ndjesinë e thellë kombëtare të shqiptarëve. Asnjë pushtues nuk ka arritur ta ndryshojë. Si rrjedhojë, te shqiptarët, ne gjejmë shenja të zakoneve më të vjetra europiane.

Sikurse malësorët skocezë, shqiptarët ishin njerëz fisesh. Këto fise formuan dy grupe që në kohët e lashta të udhëhequra nga prijës të ndryshëm. Këto dy grupe ne mund t'i gjejmë edhe sot si Gegë në Veri dhe Toskë në Jug. Ata i përkasin të njëjtës racë dhe flasin të njëjtën gjuhë. Megjithatë, gegët jetojnë në toka më të ashpra, dhe përmes mburojave natyrore të maleve kanë arritur

249 Titulli origjinal- "Albania- Oldest and quaintest of Balkan peoples" (Shqiptarët, raca më e vjetër dhe më e veçantë e Ballkanit"). Botuar në revistën "Peoples of all nations"(Vende dhe Popuj) më 25 janar 1934, Londër, Britani e Madhe. Shkruar nga Sir J. A. Hammerton. E përkthyer në shqip Astrit Hykaj.

të ruajnë disa tipare më të vjetra sesa toskët e jugut. Në malet Veriore edhe sot e kësaj dite vazhdon të mbizotërojë farefisnia. Pa marrë parasysh pushtimet dhe shtypjen, të parët e fiseve kanë udhëhequr sipas zakoneve dhe rregullave të pashkruara të lashtësisë. Këto janë trashëguar brez pas brezi dhe vihen në jetë nga pleqëria në emër të të gjithë fisit.

Shqiptarët e Veriut kanë vazhduar të shfaqin me kokëfortësi qëllimin e ruajtjes së kishës katolike romane nga një numër i madh fisesh. Shqiptarët u kristianizuan shumë herët dhe Shkodra ishte nën Patriarkatin e Romës shumë shekuj përpara se serbët dhe bullgarët e pafe u kthyen në kristianë. Pa marrë parasysh vuajtjet dhe mundimet që morën përsipër, gjatë kohës që shqiptarët e Veriut ranë nën sundimin serb të mesjetës, ata janë nga të paktët e racave të Ballkanit që vazhdimisht nuk pranuan t'i bashkëngjiten Kishës Ortodokse të Lindjes.

Çdo fis ka një shenjt, dhe deri para Luftës së Parë Botërore, kur barinjve nuk u mungonin bagëtia, ia festonin ditën këtij shenjtori në mënyrë të shkëlqyer. Dyert e shtëpive hapeshin për të gjithë bashkëbesimtarët të cilët mblidheshin rreth kishës së vogël në masë të madhe dhe gjunjëzoheshin në oborrin e saj në rreshta të gjatë. Kur mesha mbaronte, ata ushqeheshin me mish qengji të pjekur deri sa të ngopeshin.

Veshjet e ngushta kombëtare ngjyrë të bardhë për burra të qëndisura me gajtanë të trashë kuq dhe zi dhe me zinxhirë të argjendtë, si dhe veshjet e zeza dhe të veçanta të grave me shamia dhe zbukurime janë një pikturë e paharruar. Vendi u shkatërrua shumë gjatë luftës, megjithatë fshatra të tëra janë rindërtuar. Kështu që edhe njëherë shqiptari del me bagëti në stane me kullota të pasura. Ndërkohë, të gjitha prodhimet i dërgon në pazarin e Shkodrës.

Banorët e qyteteve, kudo në Shqipëri, bëjnë një jetë ndryshe nga ajo e bashkëkombësve që jetojnë nëpër fshatra. Banori i qytetit është në përgjithësi mjeshtër i zoti në punime zejtarie. Pothuajse të gjitha zbukurimet me ar në Ballkan janë punë e shqiptarëve. Veshjet mahnitëse të Oborrit Mbretëror Malazet janë bërë nga rrobaqepës shqiptarë. Gjithashtu, pothuajse të gjitha punimet në argjend janë shqiptare ose me origjinë shqiptare.

Ajo çfarë të shton kërshërinë, është se shumica e ojnave

të përdorura janë shëmbëlltyrë e zburimeve të gjetura në shpella prehistorike. Kjo tregon se qoftë ojnat, qoftë zejtaria janë trashëguar nga ilirët e lashtë. Në çdo qytet është e përhapur në mënyrë të gjerë puna me vegjë. Përmes tyre, ata shpesh prodhojnë sende prej mëndafshi, pambuku dhe leshi të bukura dhe me ojna të ngatërruara. Siç ndodh zakonisht në Ballkan, shtëpitë janë në mes të oborrit ose kopshtit, të rrethuara me mure të larta. Banorët bëjnë zakonisht jetë të thjeshtë. Orenditë shtëpiake janë të pakta, pa shumë sende të varura në muret e bardha, dyshemeja zakonisht e shtruar në dërrasa me një qilim sipër. Shqiptarët mund të merren nga të tjerët si shembull i pastërtisë.

Nëpër qytete mund të gjesh kisha dhe xhamia. Kur turqit më në fund pushtuan Shqipërinë në fund të shekullit të pesëmbëdhjetë, shqiptarët për vite me radhë iu lutën europianëve kristianë për ndihmë. Këtë ndihmë, ata e kërkuan veçanërisht nga Venecia. Kjo ndihmë nuk erdhi kurrë dhe në shekullin e tetëmbëdhjetë, Islami filloi të përhapej në Shqipëri ashtu si edhe në vende të tjera të Ballkanit.

Sidoqoftë, shqiptarët vendosën racën përpara besimit fetar dhe qoftë kristianët, qoftë muslimanët luftuan së bashku kundër turqve për pavarësinë e tyre. Muslimanët shqiptarë nuk janë fanatikë: në përgjithësi, muslimanët i përkasin sektit liberal të bektashinjve. Martesat e përziera midis muslimanëve dhe kristianëve ndodhin shpesh në Shqipëri. Kjo pa marrë parasysh urdhrat e lëshuar nga priftërinjtë dhe ndodh shpesh që në një familje të gjesh anëtarë të dy besimeve fetare të ndryshme. Shumica e fiseve janë të përzier dhe, si kristianët ashtu dhe muslimanët, ndihen njësoj shqiptarë. Në zonat e thella, besëtytnitë e vjetra vazhdojnë të jenë të pranishme mes njerëzve. Frika ndaj magjisë dhe syrit të keq shqetëson shumicën e tyre.

Shqipëria ka një sistem arsimor të detyrueshëm për të gjithë fëmijët e moshave gjashtë deri në trembëdhjetë vjeç. Megjithatë, mungesa e shkollave e bën të pamundur zbatimin e plotë të ligjit. Gjithashtu, mungojnë njerëzit me arsim të lartë, kështu që njohuritë e trashëguara brez pas brezi e zëvendësojnë hapësirën e lënë bosh. Në Shqipëri mund të gjesh plot fshatarë të cilët mund të shërojnë sëmundje të ndryshme. Por atje mund të takosh edhe kirurgë shumë të aftë, që mund të kryejnë operacione, dhe e

njohin shumë mirë trajtimin me antiseptik (dezinfektim). Në të vërtetë, kjo mënyrë operimi është përdorur në Shqipëri shumë kohë më përpara se të njihet në Angli. Plagët janë shëruar me raki, në vend që të lahen me ujë që kur s' mbahet mend. Ndonjë fshatar i mençur mund edhe të ngjisë një kafkë të dëmtuar nga ciflat e një gjyleje topi.

Një nënë shqiptare duhet të bëjë shumë gjëra. Asaj i duhet të gatujë bukën e misrit dhe pastaj ta pjekë në çerep nga poshtë dhe me saç nga sipër mbi të cilën hidhen plot gaca zjarri. Ajo e ruan me kujdes shpuzën dhe, pasi ajo ftohet, e përdor atë në vend të sapunit për të larë rroba të cilat zbardhen në mënyrë të mahnitshme. Drithi bluhet në mullinj të vegjël primitivë me rrotulla druri që mund t'i gjeshe pothuajse në çdo përrua. Nëna, gjithashtu, tjerri leshin të cilin pastaj e dërgon në mullirin e shajakut ku dy çekicë të rëndë druri të vënë në punë nga rënia e lirë e ujit, e godasin dhe e shtrijnë duke e kthyer në shajak për tirk.

Zjarri i vatrës asnjëherë nuk fiket. Gjatë natës, ai mbulohet me hi me kujdes. Në rast se mashkulli i fundit i shtëpisë vdes, gruaja me qëllim e fik zjarrin në shenjë zie dhe vajtimi. Lumenjtë në disa vende ende kalohen në mënyrë primitive si me lëkurë deleje e fryrë ose me trap.

Gjuha shqipe, që flitet nga fushat e Kosovës deri në Gjirin e Artës, i ka çuditur gjuhëtarët. Ajo ka një gramatikë shumë të ngatërruar ariane dhe thelbi i kësaj gjuhe, pa dyshim, është ilirish-tja e lashtë, të cilën e flisnin si Aleksandri i Madh, ashtu edhe burrat maqedonë që e ndoqën nga pas. Këtë e pohon në shkrimet e tij Straboni në shekullin e parë të e.s., duke shpjeguar se të dyja palët flisnin të njëjtën gjuhë.

Çdo shqiptar, musliman apo kristian, e çmon këtë gjuhë me kokëfortësi dhe ndjenjë deri në heroizëm. Serbët, grekët, dhe turqit në mënyrë të dëshpëruar u përpoqën ta shkatërronin gjuhën shqipe. Serbët dhe malazezët grabitën shumë toka shqiptare dhe kurrë nuk i lanë shqiptarët të hapin një shkollë apo të botojnë një gazetë në gjuhën e tyre. Kristianët e Shqipërisë së Jugut i përkasin Kishës Ortodokse të Lindjes. Njëherë, këtu një prift grek e mallkoi gjuhën shqipe dhe priftërinjtë e tjerë ortodoksë u thanë njerëzve se është e kotë të luteni në gjuhën

shqipe, pasi që Krishti nuk e kupton atë. Turqit ndëshkonin me pesëmbëdhjetë vite burg këdo që mësonte apo shkruante gjuhën e “ndaluar”.

Megjithatë, shqiptari këmbëngulës dhe kokëfortë, shtypte librat jashtë dhe i sillte ata në Shqipëri, me gjithë vështirësitë dhe rrezikun që e kërcënonte. Ai, gjithashtu, shfrytëzoi ndihmën nga jashtë që jepnin Italia dhe Austria të cilat përpiqeshin ta aneksonin Shqipërinë. Këto të fundit filluan të hapnin shkolla në garë me njëra-tjetrën në Veri për qëllime propagande, për të cilat turku nuk ndërhynte.

Shqiptari mësoi dhe mbeti shqiptar. Kur u dha mundësia, ai i mbaroi studimet në Vjenë dhe Paris. Shumë studentë janë stërvitur në “Kolegjin Robert” nga amerikanët. Tani që shqiptarët kanë siguruar pavarësinë, mbahen fort pas gjuhës së tyre. Shumë shqiptarë ranë dëshmorë për çështjen kombëtare dhe pas një kohe të gjatë ata dolën fitimtarë. Të paktën shqiptarët e kanë të siguruar pavarësinë dhe, nën udhëheqjen e Mbretit Zog, i cili erdhi në fron më 1928, kanë gëzuar paqe dhe zhvillim në një shkallë që rrallëherë e kanë parë në të shkuarën e tyre historike të trazuar.